



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-3250/14
Nr. I faq. Broj stranica 02	Data Datum 16-09-2014
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.09.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2456/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Sokol Duraku, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi qe nuk ushtron me funksion ne biznes privatë.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2456/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Sokol Duraku, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës .

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës, është duke ushtruar edhe funksion në veprimtari private pra si person i autorizuar në një biznes privat, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 16.07.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Sokol Duraku, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar që ti bëhet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë në takimin që është mbajtur me z. Duraku, me datën 24.07.2014 e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrim të funksionit publik, ndërsa, z. Duraku është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se në afat sa me të shpejt do të tërhiqet nga personi i autorizuar në bizneset private edhe pse disa nga to nuk zhvillojnë aktivitete, dhe do bëjë ndryshimet e nevojshme dhe do të shmanget nga situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Me datën 11.09.2014, z. Sokol Duraku, ka sjellë në Agjenci dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuara dhe se në biznesin privat me nr. biznesi 70621460 dhe emër N.P.T. "NEW FASHION" - zyrtari në fjalë nuk figuron si person i autorizuar në këtë kompani pasi që ka emëruar një person të autorizuar në këtë biznes, po ashtu si person të autorizuar ka emëruar një person në bizneset me nr. 70537168 "UNIVERS ACCOUNTING" dhe N.T. "Dredhëza" 70509024 që thotë nuk zhvillon aktivitete.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik me largimin e tij nga funksioni i personit të autorizuar në bizneset private "N.P.T. "NEW FASHION, UNIVERS ACCOUNTING" dhe N.T. "Dredhëza", ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

